



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING	
Njësia Org. Org.Jedinica Org.Unit	01919
Nr.Prot. Broj.Prot. Prot.No.	2027-3/26
Nr. ffaqeve Broj.stranica No pages	-03-
Data Datum: Date.	03.09.2026
PRISHTINË/A	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	28.08.2026
REFERENC-Ë:	26/2027/-2/DMM
PËR/ZA/TO:	"Qëndresa" Sh.p.k., Gllarevë, Klinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka shqyrtuar Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të dërguar nga kompania e juaj sipas kërkesës me nr.prot.: 26/2027/-2/DMM dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur sikurse në vendimin e bashkangjitur kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për **Përfundim të Procedurës Administrative** për kërkesën e kompanisë "Qëndresa" Sh.p.k., Gllarevë, Klinë -- për përpunimin dhe seperimin e zhavorrit në Kramovik, Rahovec.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive Shtetërore, duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit Nr.08//L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, mbështetur në mendimin profesional të Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Vendimi Nr.3958-4/23 datë 21.04.2026), në pajtim me shtojcën 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nxjerr:

V E N D I M

Përfundim të Procedurës Administrative të kërkesës së kompanisë "Qëndresa" Sh.p.k., Gllarevë, Klinë - për përpunimin dhe seperimin e zhavorrit në ngastren kadastrale P-71510039-00132-0 në Z.K., Kramovik, Rahovec.

A r s y e t i m



Gjatë shqyrtimit të Kërkesës, Raportit të VNM-së dhe dokumentacionit përcjellës të Kompanisë "Qëndresa" Sh.p.k., Gllarevë, Klinë - për përpunimin dhe seperimin e

zhavorrit në Kramovik, Rahovec, është konstatuar se mungon dokumentacioni në vijim:

-Pëlqim nga Komuna e Rahovecit që e vërteton lejimin e veprimtarisë në fjalë në ngastrën P-71510039-00132-0;

-Kopja e planit;

-Raporti i VNM –së duhet të përmirësohet dhe duhet të bëhet në baze të Udhëzimit Administrativ nr. 04/2025, si dhe të eliminohen përsëritjet e informacioneve të panevojshme si dhe të vendosen koordinatat e lokacionit të veprimtarisë në fjalë.

Bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për VNM, Neni 17, paragrafi 2, 3 dhe 4, kompanisë “Qëndresa” Sh.p.k., Gllarevë, Klinë – për përpunimin dhe seperimin e zhavorrit në Kramovik, Rahovec, me datën 07.07.2026 i është dërguar njoftim për plotësim dokumentacioni.

Kompania “Qëndresa” Sh.p.k., Gllarevë, Klinë me datën 17.07.2026 ka sjellë plotësimin e dokumentet, mirëpo dokumentet e sjelluara nuk janë në përputhje me kërkesën për plotësim dokumentacioni.

Bazuar në të lartcekurat, Sekretari i Përgjithshëm i MMPH-së merr vendim për **Përfundim të Procedurës Administrative**, për kërkesën për pajisje me Pëlqim Mjedisor për kompaninë “Qëndresa” Sh.p.k., Gllarevë, Klinë – për përpunimin dhe seperimin e zhavorrit në ngastren kadastrale P-71510039-00132-0 në Z.K., Kramovik, Rahovec.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

Vërejtje: Vonesat në kthimin e përgjigjes janë shkaktuar për shkak të volumit të madh të kërkesave dhe ndërrimit të Komisionit për VNM.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/2027/- ZSP/ /26 datë: 28.08.2026

Prishtinë



T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. AMMK-së
5. Kabinetit të Ministrit
6. Komunës së Rahovecit
7. Divizionit për komunikim me publikun
9. Arkivit të MMPH

UD i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH